



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KONTRATA

E përpiluar me datën 29.11.2019 ne Lipjan ndërmjet:

- Komunës së Lipjanit të cilën e përfaqëson Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan z. Adem Duriqi në njërën anë (në tekstin e mëtejme) Autoriteti Kontraktues dhe

Emri i Kontraktuesit Operatori ekonomik NTP "Eurocoop" nga Shtimja të cilin e përfaqëson Skender Gashi drejtor në vazhdim përdoret (shkurtesa) Kontraktuesi

Titulli i Kontratës: "Furnizimi dhe montimi i dyerve në disa shkolla të Komunës së Lipjanit"

Nr referues i kontratës 613 019 138 536

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës është: **"Furnizimi dhe montimi i dyerve në disa shkolla të Komunës së Lipjanit"** të gjitha të parapara të pershkrimi i çmimeve.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me vënien e nënshkrimit nga të dy palët, gjegjësisht me 29.11.2019 dhe përfundon maksimumi 15 ditë pune pas nënshkrimit të kontratës apo deri më 16.12.2019

1.3 Afati kohor i performancës nuk mund të jetë më shumë se 15 ditë pune nga nënshkrimi i kontratës.

1.4 Vendi i kryerjes së furnizimeve dhe montimeve janë shkollat: SHFMU "Vezir Kolshi" në Baice, SHMLM "Shaqir Hoxha" Shalë, SHFMU "Vëllezërit Domeneku" Topliqan, SHFMU "Shtjefen Gjeqovi" Janjeve.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata Komunale Lipjan.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi përgjithshëm i kontratës shprehur në shifra është **4,920.00€** me fjalë katërmijë e nëntëqind e njëzetë /euro/ e zero /cent/

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro. Pagesa do të bëhet pas furnizimit dhe montimit të të gjitha dyerve.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës nëse fatura e ka të bashkangjitur raportin e menaxherit të kontratës se shërbimet janë kryer me cilësi dhe në afat sipas planit dinamik të paraparë në kontratë. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve dhe montimit të dyerve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dësjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Kontraktuesi duhet të garantojë që furnizimet janë të reja, të papërdorura, të modelit më të fundit dhe që inkorporojnë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në material. Kontraktuesi do të garantojë se asnjë nga furnizimet nuk kanë asnjë defekt që shkaktohet në materialet dhe kryejnë funksionin pa pengesa.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera

të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,5% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë dyert që janë përgatitur për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse ato kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Menaxher i kontratës është Brahim Durqi nr tel: 044 136 804.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

.13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën komunale në Lipjan në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqip në 4 origjinale, 3 origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Adem Duriqi	Emri:	Skender Gashi
Pozita:	Drejtor i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	29. 11. 2019
Vula:		Vula:	



	Pershkrimi	Dimensionet	Njesia	Sasia	Qmimi	Totali
I	SHFMU,,Vezir Kolshi,, në Baicë					
	Dyer komplet (dyert & kornizat), duke përfshirë largimin e dyerve të vjetra dhe sanimin e defekteve pas vendosjes së dyerve të reja	Dyer (196x85cm) & Korniza (31cm)	cope	4	170.00	680.00
	Dyer vetem krah (pa kornize) me mekanizem te mbylljes	Dyer 196x85 cm	cope	2	100.00	200.00
	TOTALI					880.00
II	SHMLM,,Shaqir Hoxha,, në Shalë					
	Dyer vetem krah (pa kornize) me mekanizem te mbylljes	Dyer 205x84cm	cope	2	110.00	220.00
	Dyer vetem krah (pa kornize) me mekanizem te mbylljes	Derë 195x85cm	cope	1	100.00	100.00
	TOTALI					320.00
III	SHFMU,,VII.Domaneku,,Topliqan					
	Dyer komplet (dyert & kornizat), duke përfshirë largimin e dyerve të vjetra dhe sanimin e defekteve pas vendosjes së dyerve të reja	Dyer (205x1m) & Korniza (28cm)	cope	8	180.00	1,440.00
	Dyer komplet (dyert & kornizat), duke përfshirë largimin e dyerve të vjetra dhe sanimin e defekteve pas vendosjes së dyerve të reja	Dyer (205x90cm) & Korniza (22cm)	cope	4	170.00	680.00
	TOTALI					2,120.00
IV	SHFMU,,Shtjefen Gjeçovi,, në Janjevë					
	Dyer vetem krah (pa kornize) me mekanizem te mbylljes	Derë 200x95cm	cope	1	100.00	100.00
	Dyer vetem krah (pa kornize) me mekanizem te mbylljes	Derë 198x95cm	cope	1	100.00	100.00
	Dyer vetem krah (pa kornize) me mekanizem te mbylljes	Derë 295x95cm	cope	1	100.00	100.00
	Dyer vetem krah (pa kornize) me mekanizem te mbylljes	Derë 198x95cm	cope	1	100.00	100.00
	TOTALI					400.00

V	SHFMU,,Vezir Kolshi,, në Baicë					
	Dyer vetem korniza	Korniza (31x196cm)	cope	1	100.00	100.00
	TOTALI					100.00
	SHFMU,,VII.Domaneku,,Topliqan					
VI	Furnizimi dhe montimi i derës së hyrjes dy krahëshe, me dy pjesë shtesë fikse, mbindriqim, me prag te aluminit jo i ngritur me profile të zgjëruara prodhues gjerman mekanizmi dhe brava të jenë nga prodhimi gjerman, (Rroto), me xham eko, me dimensione 522x280cm, te jete nga materiali PVC me t=8cm, me karakteristika termoizoluese të nivelit, me tre goma duke ofruar mbrojtje perfekte nga humbja e energjise dhe rrit izolimin e zerit, karakteristikat teknike: $U_f = 1.3 \text{ w/m}^2 \text{ K}$, izolimi i zhurmes deri ne 46 dB.lyrja rreth deres me llaq dhe ngjyrë pas montimit.	Derë e hyrjes	cope	1	1,100.00	1,100.00
	TOTALI					1,100.00
	TOTALI I PERGJITHSHEM					4,920.00